

**Informacion mbi REALIZIMIN E TREGUESVE EKONOMIKO – FINANCIAR TE BASHKISE
VLORE
PËR VITIN 2017**

E nderuar kryetare e Këshillit të Bashkisë,

Të nderuar këshilltare!

Qëllimi i Informacionit: Administrata e Bashkisë i paraqet Këshillit të Bashkisë raport të monitorimit dhe zbatimit të buxhetit për vitin financiar 2017.

Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Baza Ligjore:

- Ligji nr.139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore" neni 44, neni 64/a, c, ç.
- Ligji Nr.9936, date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", neni 62, 65.
- Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" neni 48, 51,
- Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar
- V.B.K.-ne Nr. 3, date 31.01.2017 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2017".

Informacion mbi realizimin e të ardhurave për vitin 2017:

Në periudhën Janar – Dhjetor 2017 Bashkia Vlorë ka mbyllur një vit financiar duke finalizuar me miratimin e buxhetit për vitin 2018. Në vitin 2017 ka hyrë në fuqi ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i cili ka sjellë ndryshme të rëndësishme në procesin administrativ të hartimit dhe zbatimit të buxhetit gjatë vitit financiar.

Në muajin gusht, kemi paraqitur përpara Këshillit të Bashkisë analizën 8 mujore, si një detyrim i ligjit të sapohyrë në fuqi dhe tashmë po e paraqesim të plotë këtë analizë. Shumë prej të dhënave janë vazhdim ose plotësim i informacionit të paraqitur në analizën mujore.

Buxheti i Bashkisë Vlore i viti 2017 ka qene nje buxhet i kategorizuar ne varësi te ardhurave te krijuara dhe financimeve nga buxheti i shtetit qe përfshin:

- Financime nga Buxheti i Shtetit
- Financime nga te ardhurat e veta
- Financime nga granti i pakushtezuar
- Financuar nga granti specifik (këtu futen funksionet e reja qe i janë shtuar pushtetit vendor dhe investimet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve)

Per vitin 2017 janë regjistruar 4,535 me NIPT ne Bashkinë Vlore, si dhe 90 qytetare si qiradhënës per taksen e pasurisë. Bazuar ne rakordimet me Degën e Thesarit Vlore, inspektorët e terrenit, agjentët tatimore, si dhe punonjësit e te ardhurave, te ardhurat janë 616,185 mije leke, me nje rritje prej rreth 14,6% nga viti 2016 ose 78,452 mije leke.

Pasqyra paraqitet si me poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Total 2016	Total 2017	Plan 2017	Krahasim 2016/2017	Krahasim Plan/Fakt
I	Te ardhura nga taksat vendore					
1	Takse për kalimin e se drejtës se pronësisë	27,101	26,884	32,450	99%	83%
2	Takse e automjeteve te përdorura	38,623	39,758	37,803	103%	105%
3	Taksa e biznesit te vogël (TATIM I THJESHTUAR)	27,646	12,516	22,000	45%	57%
4	Takse e pasurisë se paluajtshme (ndërtesat + toka bujq.)					
4.1	Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa	105,606	107,361	137,148	102%	78%
4.2	Takse pasurie e paluajtshme toke bujqësore	24,887	12,886	42,455	52%	30%
5	Takse trualli	7,120	8,336	7,000	117%	119%
6	Takse e fjetjes ne hotel	3,534	6,571	7,560	186%	87%
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndërtimet e reja					
7.1	Takse e ndikimit në infrastrukturë (Drejtoria e Planifikimit Urban)	37,748	134,984	408,320	358%	33%
7.2	Takse e ndikimit në infrastrukturë (ALUIZNI)			40,645		
8	Takse table + reklame	12,791	13,215	11,385	103%	116%
9	Takse parkimi	2,814	2,171	10,000	77%	22%
II	Te ardhurat nga tarifat vendore					
1	Tarife për zënien e hapësirave publike					
1.1	Tarife tregu	10,601	12,531	9,302	118%	135%
1.2	Tarife e zënies se hapësirave publike	42,563	28,913	44,765	68%	65%
2	Tarife vjetore për pastrimin urban + ndriçim + gjelbërim	96,233	115,866	150,605	120%	77%
3	Tarife shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi		1,611	21,616		7%
4	Tarife për leje dhe shërbim veterinar	1,062	1,100	1,035	104%	106%
5	Tarife për shërbime te tjera nga pushteti vendor	8,950	11,864	20,117	133%	59%
6	Tarife për leje dhe certifikata transporti	3,019	3,874	11,202	128%	35%

III	Te ardhura te tjera					
1	Te ardhura nga qiratë (mjete+godine+toke)	3,598	2,178	41,703	61%	5%
2	Te ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	63,275	55,218	52,900	87%	104%
3	Te ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat	17,769	16,755	20,826	94%	80%
4	Te ardhura nga institucionet vartëse					
4.1	Te ardhura nga teatri “Petro Marko”	1,600	532	1,200	33%	44%
4.2	Te ardhura nga Qendra Kulturore	1,193	1,061	1,700	89%	62%
	TOTALI	537,733	616,185	1,133,737	115%	54%



Siç pasqyrohet edhe ne tabele, realizimi vjetor ne vlere absolute është 616,185 mije leke, kurse ne përqindje duke e krahasuar me planin për këtë periudhe është 54 % (616,185/1,133,737). Ky realizim i krahasuar me vitin 2016 është 114.6%.

Të nderuar këshilltarë !

Arkëtimi i te ardhurave behet nga Sektori i Tatimeve ne Bashki, Agjentet tatimore (institucione shtetërore), si dhe kontrata ne partneritet privat – publik. Në tabelën e mëposhtme kemi evidencën e të ardhurave sipas zërave te cilët arkëtohen nga vetë Bashkia Vlore për vitin 2017

EMERTIMI	Total 2016	Total 2017	Plan 2017	Krahasim 2015/2017	Krahasim 2016/2017	Krahasim Plan/Fakt
Te ardhura nga taksat vendore						
Takse pasurie e paluajtshme ndërtesa	105,606	107,361	137,148	161%	102%	78%
Takse pasurie e paluajtshme toke bujqësore	24,887	12,886	42,455	87%	52%	30%
Takse trualli	7,120	8,336	7,000		117%	119%
Takse e fjetjes ne hotel	3,534	6,571	7,560	155%	186%	87%
Takse tabele + reklame	12,791	13,215	11,385	254%	103%	116%
Takse parkimi	2,814	2,171	10,000	110%	77%	22%
Te ardhurat nga tarifat vendore						
Tarife tregu	10,601	12,531	9,302	138%	118%	135%
Tarife e zënies se hapësirave publike	42,563	28,913	44,765	423%	68%	65%
Tarife vjetore për pastrimin urban + ndriçim + gjelbërim	96,233	115,866	150,605	231%	120%	77%
Tarife për leje dhe shërbim veterinar	1,062	1,100	1,035	235%	104%	106%
Tarife për shërbime te tjera nga pushteti vendor	8,088	11,864	20,117	82%	147%	59%
Tarife për leje dhe certifikata transporti	3,019	3,874	11,202	205%	128%	35%
Te ardhura te tjera						
Te ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	63,275	55,218	52,900	133%	87%	104%
TOTALI	381,593	379,906	505,474	175%	100%	75%


Sic pasqyrohet edhe ne tabele, realizimi vjetor i taksave ne vlerë absolute është **379,906** mijë lekë, kurse në përqindje duke e krahasuar me planin për këtë periudhë është **75%** (**379,906/505,474**). Ky realizim i krahasuar me vitin e mëparshëm 2016, është **100%**.




Me poshte po analizojme disa nga taksat qe kane peshe ne buxhetin e vitit 2017 (ne/000 leke).

A-TARIFA për ndriçim, pastrim e gjelbërim dhe taksa e pasurisë


Po i analizojmë per lehtësi të bashkuara këto tarifa ne një te vetme.




Taksa e pasurisë




Tarifa per ndriçim, pastrim e gjelbërim



B-TAKSA E REKLAMES DHE TABELES



C-TAKSA PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Informacionin ne lidhje me perdorimin e hapësire publike si stacion plazhi, e cila per vitin 2017 rezulton:

Njesia Vlore	12,569 m ²
Njesia Qender	13,200 m ²
Njesia Oriku	18,504 m ²


Total	44,273 m²
--------------	-----------------------------

Ne baze te VKB nr.44 date 28.12.2015, pika VI është ngritur komisioni i verifikimit te pasurive i cili ka operuar ne teren për vitin 2017

Komisioni ka marr parasysh dhe Vendimin Nr. 17, Datë. 31.03.2016 "Per disa ndryshime ne VKB nr.44 date 28.12.2015 "Per miratimin e sistemit te taksave dhe tarifave ne territorin e Bashkise Vlore", sipas pikës 1 subjektet qe kane ushtruar aktivitet tregtar ne zonen prej ish Postes Skele deri te Bufe Shpella ne Ujin e Ftohte, për periudhën qe u zbatua projekti "Vija bregdetare e qytetit te Vlores-Lungomare", kane përfituar nje ulje ne masen 30% te taksës se pasurise, si dhe pikës 2 "Subjektet qe ushtrojne aktivitet tregtar ne zonen prej Ish Postes Skele deri te Bufe Shpella, ne Ujin e Ftohte, per periudhën qe do te zbatohet projekti "Vija bregdetare e qytetit te Vlores-Lungomare" nuk jane tarifuar per zenien e hapësires publike.


Nga verifikimet ne terren rezultojnë se nga kjo VKB kane përfituar 105 subjekte. Kjo e përkthyer ne vlere monetare sipas VKB nr.44 date 28.12.2015 "Per miratimin e sistemit te taksave dhe tarifave ne territorin e Bashkise Vlore, eshte ne vlerën 10,800 mije leke vetëm per tarifën e zënies se hapësirës publike (6000m²*300leke/muja*6muaj)

D – TAKSA E FJETJES NE HOTEL



Per vitin 2017 kemi nje rritje me 86% ne vlerën e arkëttimeve kjo si rrjedhoje e inspektimeve te kryera ne terren, dhe rritjes se numrit te turisteve per vitin 2017. Kjo takse eshte nje tregues real i rritjes se numrit te turisteve ne Bashkinë e Vlorës.

E - TARIFA TE TJERA



Kryesisht puna e drejtorisë gjate vitit 2017 eshte përqendruar ne mbledhjen e detyrimeve te prapambetura, dhe mund ta quajmë kete si shume te suksesshme duke pare ne përgjithësi gjendjen financiare te subjekteve debitore. Kemi arritur qe te bëjmë te mundur shlyerjen e detyrimeve prej subjekteve problematike debitor prej vitesh.

Per periudhën vitin 2017, nga ana e sektorit te Borxhit janë kryer këto veprime:

- a. Njoftime
 - per pagese debie 1,157 subjekte
 - njoftim tatim paguesi per vendosje te masave siguroese 884 subjekte
 - Totali i njoftimeve 2,799 subjekte
- b. Masa shtrënguese ndaj tatim paguesve
 - Bllokim te llogarive bankare 1,415 subjekte
 - Vendosje te barrës hipotekore ne ZVRPP 981 subjekte
 - Vendosje te barrës siguroese ne Drejtorine Rajonale te Transportit Rrugor 981 subjekte
 - Vendosje te barrës siguroese ne QKB 556 subjekte
- c. Ekzekutim Urdhrash 211 subjekte

Si pasojë e këtyre veprimeve janë arkëtuar nga Sektori i Borxhit në **total 55,219 milionë** lekë.

Nga analiza e tregueseve te mësipërme dalin dhe disa detyra per përmirësimin e punes dhe rritjen e te ardhurave ne vazhdim:

1. Do te intensifikohen kontrollet ne teren, jo vetëm nga inspektorët e kontrollit por edhe me grupe pune, policinë bashkiake dhe rajonet
2. Do te bashkërendojmë punën me sektorin e kontrollit-borxhit per te intensifikuar punën ne mbledhjen e detyrimeve debitorësh dhe bashkëpunim me te ngushte me institucionet nga te cilat subjektet kane vartësi (Drejtoria Rajonale e Tatimeve, ZRPP -KSHA) etj
3. Për probleme te veçanta me peshe ne te mbledhjen e te ardhurave, si per subjekte me SPL, tabele reklame, takse fjetje ne hotel, do te veprohet me programe dhe grupe pune te posaçme, pavarësisht nga shtrirja e subjekteve neper rajone.
4. Bashkëpunimi me QKB për mbledhjen e detyrimeve vendore per subjektet qe çregjistrohen apo pezullojnë aktivitetin.
5. Në rritjen e të ardhurave të taksës dhe tarifave familjare 3 mujorin e fundit te vitit 2017 ka ndikuar edhe reforma e cila po zbatohet nga Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve e cila luan dhe rolin e agjentit tatimor. Grupet e përbashkëta te punes ndërmjet SH.A. Ujësjetës, Adminsitrata Tatimore kane bere qe treguesit ekonomike te vine gjithmonë e ne rritje.
6. Duke qenë se problemi kryesor mbetet arketimi i tarifave familjare ne zonat rurale, në paketën fiskale të miratuar në muajin dhjetor të vitit 2017, është parashikuar Në Njësitë Administrative, për familjet te cilat nuk janë te lidhura me rrjetin e Ujësjetës, tarifa e pastrimit do te faturohet dhe do të mblidhet nga Ujësjetës Sha. Administratoret e njësite Administrative, së bashku me Kryepleqtë kanë për detyrë të evidentojnë familjet që nuk janë të lidhur me rrjetin e Ujësjetës. Listat e përditësuara do të dorëzohen pranë Drejtorisë se Menaxhimit Financiar, Bashkia Vlorë

7. Do te vazhdojmë komunikimet me Ministrinë e Financave dhe Drejtorine e Tatim Taksave si agjente tatimore, per rritjen e arketimit te pagesave te qirave te kontratave te trojeve nen objektet e privatizuara nga AKP.

8. Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Inspektoret e terrenit se bashku me Administraten e Njesive do te intensifikojnë punen ne terren me fermerët per te sensibilizuar fermeret per pagesën e taksës së tokës bujqësore.

Informacion mbi realizimin e shpenzimeve per Vitin 2017

Bashkia Vlore per vitin 2017 ka qene e kujdesshme ne shpenzimet e kryera, kjo per arsye te likuidimit te te gjitha detyrimeve te prapambetura, por edhe per te qene ne proporcion me mundësitë reale financiare, duke ulur shpenzimet korente te planifikuara, si dhe ulur shpenzimet për administratën pa prekur shpenzimet e domosdoshme. Bashkia Vlore nuk ka lejuar te kryeje shpenzime përtej shumes maksimale te shpenzimeve te përcaktuara ne zërat përkatës te buxhetit.

Treguesit e shpenzimeve për vitin 2017, kane paraqitjen e mëposhtme (tregues te përmbledhur):

a. Nga te ardhurat e veta (Burim financimi)

Nga te ardhurat e veta, administrata ka pasur ne dispozicion per vitin 2017 fonde te çelura për përdorim nga dega e thesarit

Plani : **527,634** mije leke janë përdorur ne fakt **520,404** mije leke ose **98,6%**

Nga detyrimet e prapambetura te raportuara per vitin 2016, janë likuiduar detyrimet e prapambetura:

1. Pastrimi	167,566 mije leke
2. Ndriçimi rrugor	4,000 mije leke
3. Administrata e Bashkisë	6,971 mije leke

Gjate vitit buxhetor 2017 detyrimet janë ne 3 kategori

1. detyrime për efekt te vendosjes se limit ne muajin Nëntor 2017 nga Ministria e Financave per te gjitha njësite shpenzuese te cilat kapin shifrën 253,003 mije leke. Këto fonde do te përdoren me vendim te veçante te Këshillit te Bashkisë Vlore. Fondet e pa likuiduara përbehen nga:

a. Te ardhurat e veta	74,828 mije leke
b. Granti i pakushtëzuar	70,252 mije leke
c. Transferta speciale	107,923 mije leke

2. Gjate 2017 kane lindur detyrime te cilat janë planifikuar te likuidohen ne vitin 2018:

a. Pastrimi	156,721 mije leke
b. Gjelbërimi	2,718 mije leke
c. Administrata e Bashkisë	3,900 mije leke
d. Vendime Gjyqi	27,860 mije leke

3. Detyrime te pa mbuluara

a. Vendime Gjyqi	76,851 mije leke
b. Detyrime te energjisë elektrike (detyrime para reformës 2015)	72,000 mije leke

ANALIZA E REALIZMIT TE TREGUESVE FINANCIAR TE VITIT 2017

a. Shpenzimet e kryera nga te ardhurat e veta per çdo institucion paraqiten si me poshtë:

TE ARDHURAT E VETA RAPORTI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2017

EMERTIMI	TOTAL		600		601		602		603		651		604		166		606		466		230 + 231	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt			Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
PASTRIMI	101,500	97,088					101,500	97,088														
GJELBERIMI	7,000	6,977					7,000	6,977														
DEKORI																						
FUNERALI																						
BASHKIA	279,812	277,299	92,024	91,987	14,600	14,598	105,543	105,156					2,905	2,497			3,701	3,701	5,239	5,239	55,800	54,121
BASHKIA KREDIA	12,975											1,764	1,764			11,211	11,211					
BASHKIA																						
BASHKIA	606	606	606	606	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
FUTBOLLI	9,220	9,220	-	-	-	-	-	-	9,220	9,220	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
UJESJELLESI	20,900	20,700	-	-	-	-	-	-	20,900	20,700	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
REPETITOR	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
PARKU. URB.	8,600	8,600	-	-	-	-	-	-	8,600	8,600	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
NDRICIMI.RRUG.	49,380	49,377	-	-	-	-	49,380	49,377	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
CERDH. DERAT.	1,585	1,508	550	521	95	87	940	900	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
ARS. 9-VJEC.	36,056	36,055	-	-	-	-	36,056	36,055	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KONVIKTET	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KULTURA	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTVet.Bashkia	527,634	520,404	93,180	93,113	14,695	14,685	300,419	295,552	38,720	38,520	1,764	1,764	2,905	2,497	11,211	11,211	3,701	3,701	5,239	5,239	55,800	54,121
Nd. e sherbimeve	18,642	15,049	2,146	2,146	1,296	1,295	15,200	11,608	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gen.Kulturore	10,100	9,308	-	-	-	-	10,100	9,308	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Klu.Shumsporthesh	9,000	8,954	-	-	-	-	9,000	8,954	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Teatri	5,215	3,800	945	938	270	269	4,000	2,594	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Sh.Femijes	2,300	1,540	-	-	50	45	2,000	1,354	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	250	141
Q.ZH.P	4,570	2,259	-	-	-	-	4,070	2,259	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	500	-
SHUM. INST	49,827	40,911	3,091	3,084	1,616	1,609	44,370	36,077	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	750	141
TOTALI	577,461	561,315	96,271	96,196	16,311	16,294	344,789	331,630	38,720	38,520	1,764	1,764	2,905	2,497	11,211	11,211	3,701	3,701	5,239	5,239	56,550	54,262

Si shifet nga situacioni shpenzimet janë kryer brenda limiteve te miratuara nga këshilli i bashkisë.

Paga + Sigurime Shoqërore:	Planifikuar 112,582 mije leke,	Realizuar: 112,491 mije leke ose 100%
Shpenzime Operative:	Planifikuar 344,789 mije leke,	Realizuar 331,629 mije leke ose 96%
Subvencione:	Planifikuar 38,720 mije leke,	Realizuar 38,520 mije leke ose 100%
Kredia:	Planifikuar 12,975 mije leke,	Realizuar: 12,975 mije leke ose 100%
Investimet e çelura:	Planifikuar 56,550 mije leke,	Realizuar 54,262 mije leke ose 96%
Ndihma dhe Përkrahje :	Planifikuar 3,701 mije leke,	Realizuar 3,701 mije leke ose 100%

ANALIZA E REALIZMIT TE TREGUESVE FINANCIAR TE VITIT 2017

b. Nga granti i pakushtëzuar (burimi i financimit), administrata ka pasur ne dispozicion fonde te planifikuara 586,643 mije leke, dhe ka përdorur 516,392 mije leke ose 88%, sipas situacionit te mëposhtëm:

GRANTI I PAKUSHTEZUAR RAPORTI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2017

EMERTIMI	TOTAL		600		601		602		651		166		230 + 231	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
PASTRIMI	155,239,000	132,429,115					155,239,000	132,429,115						
GJELBERIMI	23,236,000	18,086,440					23,236,000	18,086,440						
DEKORI	3,570,000	1,613,054					3,570,000	1,613,054						
FUNERALI	10,217,000	7,919,163					10,217,000	7,919,163						
BASHKIA	253,074,450	224,838,283	59,000,000	58,940,258	10,620,000	10,610,714	12,303,450	10,490,167					171,151,000	144,797,144
BASHKIA KREDIA	3,750,000	3,750,000									3,750,000	3,750,000		
BASHKIA	1,114,000	1,113,800							1,114,000	1,113,800			0	0
REPETITOR	96,000	96,000					96,000	96,000						
NDRICIMI.RRUG.	17,825,000	15,236,816	5,000,000	2,818,594	825,000	471,812	12,000,000	11,946,410					0	
CERDH. DERAT.	6,650,000	6,583,512	5,700,000	5,641,400	950,000	942,112	0	0						
ARS. 9-VJEC.	13,060,000	9,866,198					13,060,000	9,866,198						
RRUGE	0	6,412,996												6,412,996
TOTALI Vetem Bashkia	487,831,450	427,945,377	69,700,000	67,400,252	12,395,000	12,024,638	229,721,450	192,446,547	1,114,000	1,113,800	3,750,000	3,750,000	171,151,000	151,210,140
Nd. e sherbimeve	31,450,000	28,102,832	19,200,000	19,186,113	2,250,000	2,250,000	10,000,000	6,666,719						
Qen.Kulturore	16,839,000	13,924,049	12,600,000	11677049	2124000	1947581	2,115,000	299,419						
Klu.Shumsporthesh	21,303,000	19,433,826	7,200,000	7067102	1200000	1181454	12,903,000	11,185,270						
Teatri	18,720,000	17,629,635	15,004,000	15004000	2376000	2376000	1,340,000	249,635						
Sh.Femijes	4,900,000	4,296,866	4,200,000	3721050	700000	575816								
Q.ZH.P	5,600,000	5,059,194	4,800,000	4335467	800000	723727								
SHUMA INSTITUCIONE	98,812,000	88,446,402	63,004,000	60,990,781	9,450,000	9,054,578	26,358,000	18,401,043	0	0	0	0	0	0
TOTALI	586,643,450	516,391,779	132,704,000	128,391,033	21,845,000	21,079,216	256,079,450	210,847,590	1,114,000	1,113,800	3,750,000	3,750,000	171,151,000	151,210,140

Paga + Sigurime Shoqërore:
Shpenzime Operative:
Kredia:
Investimet e çelura:

Planifikuar 154,549 mije leke,
Planifikuar 256,079 mije leke,
Planifikuar 4,864 mije leke,
Planifikuar 171,151 mije leke,

Realizuar: 149,470 mije leke ose 96.7%
Realizuar: 210,848 mije leke ose 82.3%
Realizuar: 4,864 mije leke ose 100 %
Realizuar: 151,210 mije leke ose 88.3%

c. Burimi i Financimit nga grantet specifike

Ne total janë planifikuar 812,169 mije leke dhe janë realizuar 669,977 mije leke, ose 82.4% sipas situacionit te mëposhtëm:

RAPORTI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2017 (GRANTI SPECIFIK)

EMERTIMI	TOTALI		600		601		602		231	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Uitja dhe Kullimi	74,676,366	50,658,677	4,092,000	3,455,842	759,000	565,402	11,542,000	3,392,027	58,283,366	43,245,406
Rruget Rurale	1,410,000	1,131,551	1,190,000	957,600	211,000	173,271	9,000	680		
FNZH	34,416,400	32,316,270	26,945,000	25,885,627	4,893,400	4,304,933	2,578,000	2,125,710		
Arsim 9 Vjecar	243,797,473	233,549,645	208,534,473	200,314,778	35,263,000	33,234,867	0			
Arsim I Mesem	23,199,792	23,199,792	19,814,000	19,814,000	3,385,792	3,385,792		0		
Konviktet	26,451,000	21,301,246	8,866,000	8,285,748	1,782,000	1,230,779	15,803,000	11,784,719		
Pyjet dhe Kullotat	3,999,108	2,449,126	3,105,000	2,089,008	529,108	360,118	365,000	0		
Investime	264,841,049	230,000,057							264,841,049	230,000,057
Investime	115,067,820	63,910,752							115,067,820	63,910,752
TOTALI Vetem Bashkia	787,859,008	658,517,116	272,546,473	260,802,603	46,823,300	43,255,162	30,297,000	17,303,136	438,192,235	337,156,215
Nd. e sherbimeve Bordi	22,680,306	9,936,201	7016531	5536385	1216775	909038	14447000	3490778		
Nd. e sherbimeve Rruget rurale	1,630,000	951,702	1414000	815340	216000	136362				
SHUMA INSTITUCIONE	24,310,306	10,887,903	8,430,531	6,351,725	1,432,775	1,045,400	14,447,000	3,490,778	0	0
TOTALI	812,169,314	669,405,019	280,977,004	267,154,328	48,256,075	44,300,562	44,744,000	20,793,914	438,192,235	337,156,215

Paga + Sigurime Shoqërore: Planifikuar 329,233 mije leke,
 Shpenzime Operative: Planifikuar 44,744 mije leke,
 Investimet e çelura: Planifikuar 438,192 mije leke,

Realizuar: 311,455 mije leke ose 91,8 %
 Realizuar: 20,794 mije leke ose 46,5 %
 Realizuar: 337,156 mije leke ose 76,9 %

Shpenzimet operative janë realizuar 46,5% si rrjedhoje e vendosjes se limit te shpenzimeve nga Ministria e Financave me Shkresën nr. 13433prot, date 02.10.2017 te ministrisë se Financave dhe Ekonomisë mbi pezullimin e fondeve mbi limit e përcaktuar. Këto fonde mbarten per vitin 2018.

ANALIZA E REALIZMIT TE TREGUESVE FINANCIAR TE VITIT 2017

d. Burimi i financimit Buxheti i Shtetit

Per vitin 2016 janë planifikuar 1,001,066 mije leke dhe realizuar 1,001,066 mije leke ose 99.8%, sipas situacionit te mëposhtëm

RAPORTI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2017 (B. SHTETIT)

EMERTIMI	TOTALI		600		601		602		604		606		231	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Gjendja Civile	22,686,000	22,421,676	10,374,000	10,324,229	1,800,000	1,593,447	632,000	624,000			9,880,000	9,880,000		
Shperblim lindje	0	0		0								0		
Emergjenca Civile	2,523,426	2,523,426							2,523,426	2,523,426				
Invalidet	485,388,303	455,413,005									485,388,303	455,413,005		
Ndihma ekonomike	0	29,975,298										29,975,298		
Invalidet	100,958,805	100,949,611									100,958,805	100,949,611		
Arsimi profesional	746,349	746,349					746,349	746,349						
Arsimi profesional	1,425,351	1,425,268					1,425,351	1,425,268						
Q.K.R	1,832,843	1,832,853	1,588,620	1,588,620	244,223	244,233		0						
Q.K.R	525,235	356,881	401,580	293,961	87,655	26,920	36,000	36,000						
Arsimi 9 Vjecar	19,694,518	19,694,518					6,173,886	6,173,886					13,520,632	13,520,632
Arsimi i mesem	153,073,058	152,952,572						0					153,073,058	152,952,572
Zgjedhjet	8,955,000	8,954,039	8,295,000	8,294,999			660,000	659,040						
Bonus strehimi	10,021,398	10,021,398									954,054	954,054	9,067,344	9,067,344
FZHR	158,282,563	158,282,563						0	0				158,282,563	158,282,563
TOTALI	966,112,849	965,549,457	20,659,200	20,501,809	2,131,878	1,864,600	9,673,586	9,664,543	2,523,426	2,523,426	597,181,162	597,171,968	333,943,597	333,823,111
Sh.Femijes	15,046,451	15,046,451	10,645,469	10,645,469	1,778,406	1,778,406	2,582,076	2,582,076			40,500	40,500		
Sh.Femijes	3,472,719	2,321,182	1,041,201	1,037,252	313,594	173,220	2,117,924	1,110,710						
Q.ZH.P	16,090,534	16,090,534	10,222,756	10,222,756	1,706,416	1,706,416	4,161,362	4,161,362						
Q.ZH.P	2,584,916	2,058,695	947,694	852,591	298,584	142,384	1,338,638	1,063,720						
SHUMA INSTITUCION	37,194,620	35,516,862	22,857,120	22,758,068	4,097,000	3,800,426	10,200,000	8,917,868	0	0	40,500	40,500	0	0
TOTALI	1,003,307,469	1,001,066,319	43,516,320	43,259,877	6,228,878	5,665,026	19,873,586	18,582,411	2,523,426	2,523,426	597,221,662	597,212,468	333,943,597	333,823,111

Paga + Sigurime Shoqërore:

Planifikuar 49,745 mije leke,

Realizuar: 48,925 mije leke ose 98.3%

Shpenzime Operative:

Planifikuar 19,874 mije leke,

Realizuar: 18,582 mije leke ose 93.5%

Ndihma dhe Perkraha:

Planifikuar 597,221 mije leke,

Realizuar: 597,212 mije leke ose 100%

Investimet:

Planifikuar 333,944 mije leke,

Realizuar: 333,823 mije leke ose 100%

Transferime te te trete

Planifikuar 2,523 mije leke,

Realizuar: 2,523 mije leke ose 100%


Përmbledhje e veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm per vitin 2017

Njësia e Auditimit të Brendshëm, ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin Nr.114 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, dt. 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, Kodin e Etikës dhe Kartës së Auditimit të Brendshëm Publik, Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”. Njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në nivel sektori me strukturë 1 përgjegjës dhe 2 inspektorë. Burimet e auditimit janë përdorur në përputhje me planifikimin. Të gjithë audituesit e miratuar në strukturë janë të çertifikuar. Janë zbatuar detyrimet e përcaktuara në Planin Vjetor të Auditimit 2017 dhe Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm 2017- 2019; NJAB ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me standardet, procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Në hartimin e programit vjetor të Auditimit të Brendshëm, miratuar nga kryetari i Bashkisë dhe Programit Strategjik për vitet 2017 – 2019”, është marrë parasysh që të përfshihen subjekte të cilët mbartin risk të lartë, si dhe janë marrë parasysh të dhënat e përcuara nga menaxhimi i lartë. Arritja e objektivave me kosto sa më të mirë ka qënë një tjetër kriter që është marrë në konsideratë për hartimin e programit vjetor .

Bazuar në planin vjetor 2017 janë parashikuar 11 auditime. Janë realizuar 11 auditime. Pra plani i auditimit është realizuar 100%

Nga auditimet e ushtruara gjatë kësaj periudhe janë dhënë rekomandime për përmirësimin në vazhdimësi të punës. Gjatë vitit 2017 janë lënë gjithësej 35 rekomandime.



Në përfundim të angazhimeve të auditimit për përmirësimin e punës në çdo institucion vartës në bazë të problematikave janë lënë rekomandimet përkatëse të cilat janë pranuar nga drejtuesit e institucioneve.

Krahas problematikës së ngritur vihet re se për gjetjet e konstatuara nga audituesit është përcaktuar përgjegjësia. Ky fakt konsiderohet si një tregues pozitiv i performancës së auditimit të brendshëm dhe tregon se rezultatet e punës janë shtrirë përtej konstatimit të gjetjeve.

Percaktimi i përgjegjësive ka sjell efekt pozitiv dhe në dhënien e propozimeve për uljen e pasojave të mangësive dhe shkeljeve të konstatuara.

Gjatë vitit 2017, një drejtim mjaft i rëndësishëm i veprimtarisë së auditimit të Brendshëm ka qënë vlerësimi dhe zbatimi i standarteve të auditimit. Proceset e auditimit të realizuara janë karakterizuar me:

- njohjen paraprake të natyrës së subjektit që auditohet,

- përcaktimin e drejtimeve dhe çeshtjeve që do të mbulojë auditimi,
- vlerësimin e riskut të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit, vlerësimin e riskut për fushat dhe sistemet dhe materialiteti,
- transparencën dhe metodën e ballafaqimit me personat përgjegjës.
- objektiviteti dhe paanësia në vlerësim,
- përgatitjen e dokumentacionit të auditimit dhe masave rekomanduese

Janë dhënë rekomandime:

Për përmirësimin e proceseve të implementimit të politikave, kuadrit ligjor e procedural të brendshëm e të jashtëm që drejton veprimtarinë e subjekteve

Për përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomi dhe efikasitet të fondeve publike

Sikurse përcaktohet dhe në misionin e auditimit të brendshëm, objektivi strategjik i tij është dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit.

Arritja e këtij objektivi përcaktohet në një masë të madhe nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e menaxhimit të subjekteve të audituara mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve. Është e njohur që përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve rëndon mbi vetë drejtuesit e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër përgjegjësia e auditimit të brendshëm nuk kufizohet vetëm në dhënien por dhe në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve pasi dhe rezultatet e punës audituese varen në një masë të madhe nga ky faktor.

Fushat me risk dhe trajtimi i tyre

Në Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm 2017-2019 dhe Planin Vjetor të Njësisë së auditimit të Brendshëm të Vitit 2017, janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e subjekteve publike. Në Ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Manualin e Procedurave janë përcaktuar dhe metodologjitë që përdoren për vlerësimin e riskut dhe pikërisht bazuar në këtë sistem të vlerësimit të riskut, audituesit programojnë dhe auditimin e fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku. Përcaktimi i fushave me risk të lartë është bërë jo vetëm në fazën e planifikimit por gjatë vitit. Qëllimi i këtyre auditimeve nuk ishte vetëm përcaktimi i dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimi dhe parandalimi i përsëritjes së shklejeve. Gjatë ushtrimit të auditimit të brendshëm në të gjithë aktivitetin e njësisë shpenzuese është përfshirë vlerësimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm, klasifikimi dhe mënyra e operimit të tij. Ky drejtim i auditimit është vlerësuar dhe është parë me përparësi, për vetë faktin se mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm, ka sjellë për pasojë: Prezencën e risqeve dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të entitetit në përputhje me programimin. Në subjektet tek të cilat auditimi i brendshëm ka identifikuar dhe përcaktuar risqet kryesore, është vënë në dijeni drejtuesi i subjektit për të marrë masat e nevojshme për minimizimin e tij. Subjektit i janë dhënë rekomandime për hartimin apo përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vitin 2017, fushat dhe sistemet pranë të cilave është evidentuar risk, në subjektet e audituara, paraqiten:

- Në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, referuar gjetjeve nga auditimet e ushtruara në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë konstatuar mangësi në regjistrin e riskut, parregullsi në procedura të përcaktuara me ligj, parregullsi në administrimin e dokumentacionit, moszbatim të akteve ligjore dhe nënligjore kryesisht mbi menaxhimin e fondeve etj.
- Në sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit, referuar gjetjeve mbi zbatimin e buxhetit janë konstatuar mungesë të buxhetit të detajuar në projektet kulturore etj

Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e efekteve të shkaktuara apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin e përsëritjen e fenomeneve të tilla në të ardhmen.

Gjetjet kryesore sipas sistemeve:

Në ushtrimin e funksionit të tyre, strukturat e auditimit, kanë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, dhe ka punuar për përmirësimin e tyre. Gjetjet e konstatuara nga strukturat e auditimit të me bazë sistemi paraqiten si më poshtë:

Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve

Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, orëve jashtë orarit

Sistemi i kontabilitetit dhe rap.financiar

Sistemi i inventarizimit

Sistemi sipas qëllimit të institucionit

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është përqëndruar tek procedurat e vendosura dhe të zbatuara për sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemin e pagesave, procedurat e prokurimit dhe administrimin e procesit të prokurimit, planifikimin e saktë të fondeve buxhetore. Sistemi i kontrollit të brendshëm në subjektet e auditura, vlerësohen në nivel të ulët, pasi në të shumtën e rasteve sistemi nuk është ngritur konform standarteve të kërkuara. Janë konstatuar problematika në mos zbatim të akteve ligjore e nënligjore dhe të procedurave për administrimin e vlerave materiale dhe monetare, ruajtjen e aseteve, kontabilizimin dhe regjistrimin e veprimeve në mbështetje të dokumentave mbështetës justifikues: në kryerjen e operacioneve financiare mbi bazën e autorizimeve e dokumentave justifikuese jo të plota, në mos përcaktimin në mënyrë të drejtë e të saktë të detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të punonjësve në rregulloren e brendshme apo përshkrimin e vendit të punës etj.

Rekomandimet e propozuara

Njësia auditimit të brendshëm e përqëndron një pjesë të madhe të përpjekjeve të saj në dhënien e rekomandimeve, të cilat synojnë përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe veprimtarisë së subjekteve të audituara për arritjen e objektivave. Për këtë qëllim, vlerësimi i sistemeve të MFK dhe veprimtarisë subjekteve të audituar shoqërohet me dhënien e rekomandimeve, të cilat duhet të jenë të sakta, realiste dhe të zbatueshme. Gjithësej janë lënë 35 rekomandime.

Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit

Sikurse përcaktohet dhe në misionin e auditimit të brendshëm, objektivi strategjik i tij është dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemit dhe shtimin e vlerës së subjektit. Arritja e këtij objektivi përcaktohet në një masë të madhe nga cilësia dhe zbatueshmëria e rekomandimeve, por tregon gjithashtu përgjegjësinë e auditimit për të gjetur rrugët më efektive për ndërgjegjësimin e manaxhimit të subjekteve publike mbi vlerën dhe përfitimet nga zbatimi i rekomandimeve.

Drejtimi ka planifikuar punën për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit me plane veprimi të konfirmuara nga titullarët e subjekteve të audituara, për tu siguruar se njësitë kanë ndërmarrë të gjitha masat ose veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve apo masave korrigjuese e këshillave të auditimit.

Veprimtaria e njësive është përmirësuar dhe standartizuar në proceset e raportimit mbi zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Respektimi i këtij standarti në formë e cilësi, si dhe respektimi i afatit të raportimit mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit, mbetet një nga detyrat kryesore e cila është nën monitorim sistematik.

Të gjitha subjektet e audituara, i janë përgjegjgur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e parregullsive, duke dëshmuar se ato kanë qënë të duhurat dhe se kanë ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit dhe shtimin e vlerës së subjekteve publike.

Duke e vlerësuar të rëndësishëm dhe qëllim final të auditimit zbatimin e rekomandimeve, në vijim do vijojë bashkëpunimin me njësitë e audituara, me qëllim që:

- Rekomandimet të jenë të qarta, të plota, dhe të ndihmojnë subjektin në përmirësimin e punës dhe ndreqjen e parregullsive.

- Rekomandimet të diskutohen dhe pranohen që gjatë fazës së përgatitjes së Projekt raportit të auditimit, duke rënë dakord për përfshirjen e tyre në Raportin Final të auditimit.

Konkluzione mbi problematikën e punës audituese.

Gjatë punës Auditimi i Brendshëm ka pasur si synim të vlerësojë nëse:

- Janë respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi.
- Burimet janë përdorur me eficiencë dhe efikasitet.
- Janë përbushur efektisht objektivat e planifikuara.
- Është përfutur dhe përdorur drejt informacioni financiar dhe operativ, për vendim-marrjen

Puna e kësaj Njësie është mbështetur në: analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion.

Prioritetet për vitin e ardhshëm

- Auditimi i subjekteve ashtu siç është parashikuar në planin strategjik 2017-2019, kryerja e misioneve të AB në përputhje me Ligjin Nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” Manualin e Ri dhe standardet e AB.
- Menaxhimin efektiv të burimeve të auditimit sa i përket përmirësimin të sistemeve duke patur në qendër vlerësimin e riskut.
- Rritjen e cilësisë së raportimit, duke respektuar standartet në fushën e raportimit lidhur me cilësinë, qartësinë dhe dobishmërinë.
- Hartimin e Raporteve të Auditimit Konform standarteve, të bazuara në fakte dhe të vlefshme në ndihmë të menaxhimit për përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit të menaxhimit dhe të operacioneve financiare.
- Realizimi i trajnimeve dhe ngritja e nivelit profesional të AB në sektorin publik.

Taulla Zanaj Dr. Drejtorise se Finance-Buxhetit

Lirika Gavani Njesia e Auditimit

MIRATOHET

K R Y E T A R

Dritan LELI